

## ON ETHICS IN THE EMERGENCY MANAGEMENT PROCESS

**Kudusi Lama**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, [Kudusilama51@hotmail.com](mailto:Kudusilama51@hotmail.com)

**Abstract:** This paper observes some of the most fundamental and enduring ethics problems in emergency management. Here we focus on some of the basic concepts of ethics in disaster relief, as well as in the organization of activities and works to prevent the consequences of natural occurrences or even human inadvertence, through which we aim to provide ethical grounds for framing issues. practical. At the same time issues that provide a historical overview of tradition and unique aspects of emergency life, participants in operations and the use of operational force to assist a disaster community.

We document and reason that ethics in the emergency management process can generate optimism by providing organizing principles, understanding the nature of the action, and developing approaches to help minimize disasters. The application of rigorous methods that characterize the seriousness of actions enables ethics in emergency management to conduct systematic analysis of challenges and formulate policy responses to improve the most of all. Ethics in the service of emergency management and in the process of completing the tasks of this system is strict. Thus, ethics in emergency situations and in the development of response operations is geared towards understanding and solving real-world problems that require crucial responses to achieve ultimate goals.

Through this paper we will also attempt to give thought to the definition of ethics, in the conditions of the modern world, when moral standards have already become universal. Evaluations will be made of tolerance ratios with ethics, predetermining persuasion not to tolerate certain behaviors. Because society expects their emergency forces to do what they are told; but it must be understood that the best way to ensure this is to create forces that need not be told. And such forces are precisely those who have perfected the will to do their duty. This is not achieved without creating a political environment of goodwill on these issues. That is why we try to answer ethics education issues, character formation of individuals, refinement of professional identity of emergency forces and so on.

**Keywords:** Ethics, Emergency Management, Emergency Situations, Education, Universal Standards, Kosovo.

## MBI ETIKËN NË PROCESIN E MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE

**Kudusi Lama**

Kolegji “BIZNESI” Prishtinë, Kosovë, [Kudusilama51@hotmail.com](mailto:Kudusilama51@hotmail.com)

**Abstrakt:** Ky punim vëzhgon disa nga problemet më themelore dhe më të qëndrueshme të etikës gjatë menaxhimit të emergjencave. Këtu fokusohemi në disa nga konceptet themelore të etikës në kushtet e përballimit të fatkeqësive, ashtu edhe gjatë organizimit të veprimtarive e punëve për parandalimin e pasojave gjatë ndodhjeve natyrore ose edhe papërgjeshmërisë njerëzore, nëpërmjet të cilit kemi për qëllim të sigurojmë bazat etike për inkuadrimin e çështjeve praktike. Njëkohësisht çështje që ofrojnë një përmbledhje historike të traditës dhe aspekte unike të jetës në situatë emergjence, pjesëmarrësit në operacione dhe përdorimin e forcës operacionale në ndihmë të një komuniteti në fatkeqësi.

Evidencojmë dhe arsyetojmë se etika në procesin e menaxhimit të emergjencave mund të gjenerojë optimizëm duke ofruar parime organizuese, për të kuptuar natyrën e veprimit dhe për zhvillimin e qasjeve për të ndihmuar në minimizimin e të këqijave të katastrofës.

Zbatimi i metodave rigorozë që karakterizojnë seriozitetin e veprimeve i mundësojnë etikës në menaxhimin e emergjencave të kryejë analiza sistematike të sfidave dhe të formulojë përgjigje të politikave për të përmirësuar shumë nga të gjitha.

Etika në shërbim të menaxhimit të emergjencave dhe gjatë procesit të plotësimit të detyrave të këtij sistemi është e rreptë. Pra, etika në situata emergjence dhe gjatë zhvillimit të operacioneve reaguese është e orientuar drejt të kuptuarit dhe zgjidhjes së problemeve të botës reale, që kërkojnë përgjigje vendimtare, për të arritur synime përfundimtare.

Nëpërmjet këtij punimi gjithashtu do të bëjmë përpjekje të japim mendime mbi përcaktimin e etikës, në kushtet e botës moderne, kur standardet morale janë bërë tashmë universale. Do të bëhen vlerësime mbi raportet e tolerancës me etikën, duke parapërcaktuar bindjen për të mos toleruar sjellje të caktuara. Sepse shoqëria pret që forcat e tyre të emergjencave të bëjnë atë që u thuhet; por duhet kuptuar se mënyra më e mirë për të siguruar këtë, është të krijojmë forcat që nuk kanë nevojë për t'u thënë. E forca të tilla janë pikërisht ato që kanë përsosur vullnetin për ta bërë detyrën e tyre. Gjë që nuk arrihet pa krijuar një mjedis politik të vullnetit të mirë për këto çështje. Prandaj edhe

përpiqemi t'u japim përgjigje çështjeve të edukimit të etikës, formimi i karaktereve të individëve, përsosjen e identitetit profesional të forcave të emergjencave etj.

**Fjalët kyçe:** Etikë, Menaxhimi i emergjencave, Situata e emergjence, Edukim, Standarde universale, Kosovë.

### 1. PËRCAKTIMI I ETIKËS

Për të pasur një identifikim sa më të qartë të përcaktimit të etikës, duhet pranuar se nuk mund të ndryshojmë natyrën, por e konsiderojmë të zakonshme dhe të domosdoshme që njerëzit në ushtrimin e detyrave të tyre në jetë dhe në institucione e veprimtari, duhet të përsosin në vijimësi sjelljen në interes të bërjes sa më mirë të detyrave. Etika nënkupton zgjedhje të një pozicioni, dhe zgjedhja nënkupton heqjen dorë prej një mase të lirisë në interes të kryerjes sa më mirë të detyrës duke përvetësuar sjellje që një profesionist e bëjnë lider.

Si një disiplinë e organizuar, teoria e etikës thekson në mënyrë sistematike arsyetimin më të mirë për të bërë zgjedhje të veçantë ose për hartimin e politikave të veçanta. "Mund të mendohet si një udhëzues për të përdorur lirinë për të zgjedhur".<sup>144</sup> Studimi i etikës i ndihmon njerëzit të bëjnë dallimin midis arsyeve më të mira dhe më të këqija dhe të zgjedhin rrugën më të arsyeshme në dritën e vlerave, për të ndërtuar politika, strategji, plane dhe organizime sa më funksionale për operacionet e emergjencave. Etika në menaxhimin e emergjencave zbatohet në një fushë të specializuar dhe zhvillon parime të përshtatshme për të ndihmuar në udhëheqjen në operacione.

Është e rëndësishme të kuptohet që etika është një disiplinë normative. Ajo merret me vlera dhe si të zgjidhni midis tyre. Ajo nuk synon të përshkruaj botën e sjelljes njerëzore ashtu siç është, por përkundrazi të përshkruaj se si duhet të jenë gjërat, duke siguruar një udhërrëfyes për përmirësimin e realitetit të jetës. Etika është natyrë për aspiratat për njerëzimin si në nivelin individual ashtu edhe në atë komunal. "Studiuesit e etikës pranojnë që njerëzit dhe institucionet e tyre janë të zgjuar, por gjithashtu supozojnë se mund të përmirësohen nëse vendimet ndjekin një analizë të kujdesshme etike".<sup>145</sup> Kur ka sjellje të pranueshme, ka edhe rezultate të larta. Në fund të fundit të zhvillosh etikën në veprim, do të thotë të gjeshtë mënyra sjelljeje e komunikimi gjatë ushtrimit të detyrës, që t'i bësh të tjerët të veprojnë me dëshirë e me kënaqësi.

### 2. ETIKA SI REZULTAT I SHFRYTËZIMIT DHE BALLAFAQIMIT TË PËRVOJAVE TË PUNËS

Në fund të fundit, kush do të thotë çfarë e dallon sjelljen e duhur nga sjellja e gabuar, ose të paktën sjellja më e mirë nga sjellja më e keqe? Çfarë i jep të drejtës etikës për të sugjeruar që disa praktika janë moralisht më të preferueshme nga të tjerët? Kush i vuri ato në krye? A nuk pretendoni në lidhje me etikën vetëm opinione? Dhe, meqenëse etika është relative, a nuk ka ndonjë mendim aq të mirë sa çdo mendim tjetër? Përgjigjet e duhura në këto pyetje bëjnë të kuptojmë se nuk ka një kornizë të përcaktuar e të dhënë në mënyrë dogmatike, por ka veprimtari etike që ka origjinalitetin e saj në çdo individ e organ qoftë drejtues ose zbatues detyrash.

Etika pra ekziston, sepse shihet se disa zgjedhje në procesin e veprimtarisë individuale a institucionale me të vërtetë janë më të mira se të tjerat. "Pjesa më e madhe e etikës përqendrohet në të kuptuarit e asaj çfarë e bën një veprim ose zgjedhje më të mirë se të tjerat".<sup>146</sup> Dhe pikërisht këtu qëndron edhe kërkesa që bëhet, për të evidencuar veprime e qëndrime, për të bërë vlerësimin e ballafaqimin midis tyre dhe për të dhënë pasqyra të rezultateve të matshme, si përvojë a si mësim të nxjerra për t'u studiuar e shfrytëzuar nga të tjerët në të ardhmen.

### 3. VLERAT E ZHVILLIMIT TË ETIKËS

Pyetja që lind është: A është toleranca etikë? Të sugjerosh që njeriu duhet të tolerojë gjithçka, sidomos në procesin e menaxhimit të emergjencave, do të thotë të përballesh me një numër problemesh, si:

Së pari, vihet re se praktikata ndryshojnë midis kulturave dhe gjatë historisë, dhe;

Së dyti, konstatohet se asnjë prej praktikave kulturore nuk është më superiore se tjetra.

Në përfundim gjykojmë se askush nuk duhet të gjykojë praktikata e një kulture si inferiore apo superiore ndaj çdo kulture tjetër. "Ky fakt na sjellë arsyetimin që në çështjet e etikës ka një standard universal - të gjithë duhet të jenë tolerantë".<sup>147</sup> Po a ka kufi toleranca në praktikën e menaxhimit të emergjencave? Etika në emergjencën na ofron argumente të menduara për detyrimin për të mos toleruar sjellje të caktuara.

Si do t'i përgjigjeshim pyetjes se çfarë është në të vërtetë një "e mirë" universale. "E para e këtyre, teoria e virtetit, luan një rol veçanërisht të rëndësishëm në përcaktimin e çfarë personi duhet të jetë një pjesëtar i forcave të emergjencave. E dyta, kërkon gjithashtu të informojë për pasojat e vendimmarrjes, por në këtë rast theksi vihet në

<sup>144</sup> Bill Rhodes, Një hyrje në etikën ushtarake: një manual referimi, (botim Anglisht), Washington 2009, faqe 2

<sup>145</sup> Po Aty, faqe 3

<sup>146</sup> Po Aty, faqe 4

<sup>147</sup> Bill Rhodes, Një hyrje në etikën ushtarake: një manual referimi, (botim Anglisht), Washington 2009, faqe 6

sjelljen e rezultateve që ndihmojnë në rritjen e lumturisë, ose, kur kjo është e pamundur, të paktën për të ulur pakënaqësinë. E treta, shërben për të informuar për vendimet, veçanërisht ato që prekin të drejtat themelore të njeriut”.<sup>148</sup>

Këto kritere kërkojnë që në situatë emergjence, shpesh vendimet të merren me keqardhje. Të gëzosh duke bërë dëm është të shkelësh kriterin. “... për të siguruar që një luftë të parandalojë më shumë dëm sesa shkakton. Të shkosh në luftë për një çështje të parëndësishme është të shkelësh kriterin”.<sup>149</sup> Pra, në kur drejtohem në vatrën e katastrofës, i çojmë njerëzit drejt rrezikut, për të nxjerrë nga rreziku disa të tjerë njerëz. Por prej këtej, dakortësohem me një arsyetim të tillë si: “Njerëzit janë përgjegjës për qëndrimet e tyre, në një mënyrë që ata nuk janë për ngjarje që nuk janë nën kontrollin e tyre”.<sup>150</sup> Dhe një përcaktim i tillë nuk është shfajësues, por është burim guximi për të gjithë ata që janë të detyruar të marrin vendime në situata të vështira. Të jesh etik, pra, do të thotë të jesh i guximshëm.

Prandaj edhe dalim në përfundimin se etika në menaxhimin e emergjencave fitohet dhe përsoset nëpërmjet trajnimit të forcave. Trajnimi kërkon të ndryshojë më shumë sesa ato që dinë ose mund të bëjnë specialistët. Ai kërkon të ndryshojë atë që u intereson atyre për interes të detyrës që do të kryejnë në operacione. “Shteti pret që forcat e tij të emergjencave të bëjnë atë që u thuhet; por duhet kuptuar se mënyra më e mirë për të siguruar këtë, është të krijojmë forcat që nuk kanë nevojë për t’u thënë”.<sup>151</sup> Prandaj kuptohet se është e qartë se trajnimi mund t’i ndryshojë njerëzit. Pyetja etike përkatëse është se në çfarë duhet të ndryshojnë.

Shumë organizata të menaxhimit të emergjencave kanë evoluar përkrahjet e llojit të personit që ata dëshirojnë të kenë anëtarët të forcave të tyre. Në mënyrë tipike, emërtohen vlera si guximi, respekti dhe përsosmëria, por shumica e listave të tilla janë aspirata të posaçme. Ato tregojnë për diçka serioze në lidhje me psikologjinë morale dhe etikën në menaxhimin e emergjencave, por megjithatë nuk ka as një kornizë të përshtatshme teorike, as një të dhënë empirike të organizuar të vendosur për të mbështetur një llogari vërtet të rreptë. Sidoqoftë, duket e sigurt të thuhet se anëtarët e forcave të emergjencave “janë të detyruar në mënyrë etike t’u shërbejnë të tjerëve, t’u binden urdhrave të ligjshëm dhe të ushtrojnë vetë-mjeshtërinë që specialitetet e tyre kërkojnë brenda udhëzimeve etike të drejtuesve”.<sup>152</sup> Operacionet e menaxhimit të emergjencave janë pothuajse gjithmonë përpjekje ekipore, që kërkojnë koordinimin e përpjekjeve individuale të shumëfishta. Në nivelin e vetë situatës së emergjencës, numrat që marrin pjesë mund të arrijnë në mijëra. Ky realitet shtyn një nevojë për të organizuar individë në grupe, që mund të funksionojnë me siguri së bashku për të përmbushur detyrat. Shtoni kushtet e vështira nën të cilat zhvillohen këto operacione dhe rëndësia thelbësore e komandës dhe kontrollit efektiv, duke përfshirë bindjen harmonike në nivelin e individit, bëhet më e qartë.

Një dështim për të punuar mirë si një mjedis operacional në situatë emergjence mund të përfundojë duke sjellë pasoja të pa riparueshme e me humbje të madhe jetë njerëzish, pasurie qytetarësh e publike dhe shkatërrim të mjedisit jetësor. Për këtë arsye, forcat e emergjencave venë theks të jashtëzakonshëm në një kërkesë etike për të vlerësuar nevojat e grupit mbi dëshirat personale të një personi.

Ndershmëria e ndërsjellë, mbajtja e premtimeve dhe trajtimi me respekt, ku të gjithë kanë tendencë të ndihmojnë anëtarët, të gëzojnë shoqërinë e njëri-tjetrit dhe të punojnë mirë së bashku, është sjellja e pranueshme etike. Nga ana tjetër, gënjeshtria, fshehtësia ose mosrespektimi kanë tendencë ta bëjnë jetën të mjerueshme duke krijuar përçarje në grup dhe duke penguar arritjen. Prandaj saktësojmë se besimi i plotë në njëri-tjetrin është një kërkesë funksionale për operacione të suksesshme emergjence.<sup>153</sup> Por sigurisht që, në botën e vërtetë drejtësia e përsosur është e rrallë, dhe të vësh gjykime të sakta për drejtësi dhe padrejtësi është e vështirë. Paqartësia pllakos statutin praktik. Kështu që, ertësia dhe vullneti i mirë janë thelbësore në këto kushte.<sup>154</sup>

Mendimi etik i zbatuar në cilindo person është i padobishëm në mungesë të vullnetit të mirë nga ana e praktikuesve. Edhe njerëzit me qëllim të mirë bëjnë gabime. Dikush mund të bëjë gabime të ndershme dhe të mbetet njeri i mirë. Historia ofron shumë shembuj të njerëzve në dukje të mrekullueshëm, të cilët vazhdojnë të shërbejnë për shkaqe të dyshimta morale. Sidoqoftë, sugjeron gjithashtu që specialistët dhe shtetarët janë të detyruar moralisht të jenë kompetent. “Morali kërkon nga shtetarët që të bëjnë çdo përpjekje për të parë të vërtetën e çështjeve dhe për të vepruar me ndershmëri”.<sup>155</sup>

<sup>148</sup> Po Aty, faqe 7

<sup>149</sup> Po Aty, faqe 24

<sup>150</sup> Po Aty, faqe 27

<sup>151</sup> Po Aty, faqe 51

<sup>152</sup> Bill Rhodes, Një hyrje në etikën ushtarake: një manual referimi, (botim Anglisht), Washington 2009, faqe 53

<sup>153</sup> Po Aty, faqe 54

<sup>154</sup> Po Aty, faqe 77

<sup>155</sup> Po Aty, faqe 78

Traditat gjithashtu shërbejnë për një qëllim sociologjik të rëndësishëm dhe etikisht të spikatur; ato ndihmojnë për të siguruar një vetë-koncept për anëtarët, si individualisht ashtu edhe kolektivisht. Anëtarët e forcave të emergjencave e kuptojnë veten si të vendosur në një vend të veçantë shoqëror, dhe kjo nga ana tjetër ndihmon në inkuadrimitin e dimensioneve etike të çdo situatë të caktuar. Një ndjenjë e traditës ndihmon gjithashtu në imperativat funksionale të kohezionit në njësi dhe përkushtimit ndaj grupit. Ajo siguron një sens lidhjeje për anëtarët e forcave të emergjencave që kanë shërbyer në të kaluarën.

Megjithatë ky koncept me mendje tradicionale dhe i bindur, mund të jetë një thikë me dy tehe. Prandaj duhet mbajtur në vëmendje se kohët ndryshojnë dhe specialistët e suksesshëm duhet të përshtaten me ta. Një nderim për të kaluarën mund të rezultojë në një rëndësi të pamjaftueshme për të tashmen. “Natyra me mendje konservatore e disa praktikave mund të pengojë funksionalitetin në një botë që nuk i përmbahet traditës”.<sup>156</sup>

Gjenerali Sir John Winthrop Hackett përmendet të jetë shprehur se “Një burrë mund të jetë i ndershëm, frikacak, jobesimtar, i rremë, i ngrënë, i shkatërruar dhe i korruptuar moralisht në një larmi mënyrash të tjera dhe akoma të jetë jashtëzakonisht i mirë në ndjekjet në të cilat mbajnë imperative të tjera se sa ato që janë mbi njeriun e mrekullueshëm. . . .”<sup>157</sup> Ajo që njeriu i keq nuk mund të jetë është një specialist i mirë, një menaxher i mirë a një drejtues i mirë në procesin e menaxhimit të emergjencave, kështu që vetëm atje ku ka burime morale ka forcë.

Max Weber e dinte gjithashtu se liderët duhet të besojnë në gjykimet e tyre, pasi nuk ka asnjë mënyrë objektive për të gjykuar midis vlerave konkurruese. “Sidoqoftë, ai priste që liderët e mirë të kishin vlera, dhe të ndiqnin një “etikë të përgjegjësive”, e cila nënkupton përpjekje për të vlerësuar qëllimet dhe mjetet për sa i përket atyre vlerave”.<sup>158</sup> Vetëm kështu mund të arrihet bashkëpunimi në gjendje emergjence, në të kundërt dështimi do të jetë i pa shmangshëm.

Miqësia zgjeron horizontet e qytetarëve, u mundëson atyre të zhvillojnë empatinë, identitetet kolektive dhe konceptet e vetë-interesimit që përfshinë mirëqenien e të tjerëve. Për Bashkëpunimi krijon dialogun, qëllimi më i rëndësishëm i të cilit është vullneti i mirë dhe miqësia që ai krijon midis bashkëvepruesve. Miqësia promovon besim dhe prirje për të dëgjuar dhe marrë seriozisht ato që thonë të tjerët, duke bashkëpunuar me ta për qëllime të përbashkëta.

Gjykimi i mirë është gjithashtu një produkt i arsyes dhe emocionit. Siç vëren Aristoteli, ne imitojmë njerëz që admirojmë dhe përdorim arsyen për të reflektuar mbi veprimet e tyre e tonat për të kuptuar pse, dhe në çfarë kushtesh, kurse të caktuara veprimi kanë sukses ose dështojnë.

Ne kemi nevojë për tipare të mira karakteri për të bërë gjykime të mira, dhe këto vijnë gjithashtu përmes përvojës dhe shfrytëzimit të mentorëve.

“Për të kuptuar si bashkëpunimin ashtu edhe gjykimin e mirë, duhet të studiojmë bashkëveprimin kompleks midis arsyes dhe emocionit, si dhe identitetit e gjykimin të mirë”.<sup>159</sup>

Duhet kuptuar gjithashtu se për të arritur rezultatet e dëshiruara në procesin e menaxhimit të emergjencave, duke reflektuar vlerat etike, duhet të mbajmë në vëmendje se “... ne duhet të përfaqësojmë, jo të shtypim, larinë dhe paqëndrueshmërinë e qenësishme të identiteteve njerëzore, interesave dhe motiveve, dhe bashkëveprimet e tyre komplekse me ligjërimet, praktikat shoqërore dhe institucionet që ato gjenerojnë dhe mbështesin”.<sup>160</sup>

Qëllimi i edukimit etik, pra, shihet si ajo që shumë e quajnë zhvillim i karakterit, me fjalë të tjera krijimi i personave moralisht të drejtë, përmes ngulitjes së disa cilësive kryesore ose dispozitave të karakterit të njohura si virtyte. “Sidoqoftë, të tjerët nuk pajtohen dhe e konsiderojnë etikën si disi të dallueshme nga morali i përgjithshëm. Përkundrazi, etika shihet më mirë si lidhje me një profesion të caktuar dhe kërkesat e saj. Përqendrimi i edukimit të etikës zhvendoset nga zhvillimi i karakterit në krijimin e një kuptimi të qëllimit dhe metodave të profesionit dhe vlerave që e mbështesin atë”.<sup>161</sup>

Në rrjedhë është me vlerë të kontribuohet për të arritur një sërë synimesh dhe objektivash të lidhura:<sup>162</sup> - për të identifikuar dhe ekzaminuar një përzgjedhje përfaqësuese të metodologjive aktuale të programeve të edukimit etik; - për të shkëmbyer ide dhe praktika më të mira nga sfera e arsimit të forcave të emergjencave; dhe të informojmë praktikuesit për atë që bëjnë të tjerët, dhe në këtë mënyrë të lehtësojmë zhvillimin e mëtutjeshëm të edukimit të

<sup>156</sup> Po Aty, faqe 148

<sup>157</sup> Bill Rhodes, Një hyrje në etikën ushtarake: një manual referimi, (botim Anglisht), Washington 2009, faqe 149

<sup>158</sup> Richard Ned Lebow - Detyrimi, Bashkëpunimi dhe Etika në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, (botim Anglisht), Washington 2007, faqe 17

<sup>159</sup> Po Aty, faqe 19

<sup>160</sup> Po Aty, faqe 24

<sup>161</sup> Edukimi i etikës në ushtri, E Redaktuar nga PAUL ROBINSON Universiteti i Otavës, Kanada dhe NIGEL DE LEE Universiteti i Hull, MB, Universiteti i Hull, MB, Britania e Madhe 2008, faqe 1

<sup>162</sup> Epo Aty, faqe 2

përshtatshëm të etikës së forcave të emergjencave; - për të identifikuar bazat e qarta ose të heshtura teorike të etikës individuale, programeve arsimore; - për të përcaktuar pse ekzistojnë programet dhe pse ndërtohen në mënyrën si janë; dhe për të realizuar një krahasim vlerësues kritik të avantazheve dhe kufizimeve të miratimit të një ose një tjetër nga këto teori si bazë për ndërtimin e programeve të tilla; - për të hetuar efektin e dallimeve kulturore dhe kombëtare në përmbajtjen dhe arsyetimin e programeve individuale; - për të zbatuar rezultatet e këtyre hetimeve për të marrë në konsideratë marrëdhëniet midis diktatit të 'moralit të zakonshëm' dhe 'moralit të rolit' duke pasur parasysh praktikën e operacioneve të emergjencave etj.

Edukimi etikë i specialistëve të menaxhimit të emergjencave duhet të përqendrohet jo në ndryshimin e karakterit, “por në ofrimin e shërbimit të burrave dhe grave për të kuptuar identitetin e tyre profesional, dhe për atë që do të thotë të jesh një profesionist”.<sup>163</sup>

Duke pasur parasysh këtë larmi, disa analiza të problemeve themelore dhe çështjeve që duhet të adresohen në një program gjithëpërfshirës të edukimit etikë mund të ndihmojnë në përcaktimin e detyrave themelore që duhet të përmbushen dhe disiplinat të kualifikohen më mirë për të kryer detyrat thelbësore. “Thelbi i përpjekjes është formimi i zakoneve përmes aplikimit të kënaqësisë dhe dhimbjes për specialistët”.<sup>164</sup>

Dikush mund të mendojë se themeli më i mirë për diskutime mbi etikën profesionale është pikërisht fakti që studentët janë anëtarë të rinj të profesionit të menaxhimit të emergjencave dhe duhet të mësojnë detyrimet e tyre profesionale. Ndërtimi i karrierës në këtë fushë kërkon përkushtim maksimal në edukimin etik. Por jo gjithmonë arrihet ajo që kërkohet ose është e nevojshme, pasi në përfundim të programit duket se pak prej studentëve kanë fituar tipare të plota etike, çka tregon se ky proces i edukimit etik është i përjetshëm.

Ka edhe mësimë mbi Kodin e Sjelljes. Ka diskutime për vlerat thelbësore të Forcës së emergjencës, dhe diskutim studimi të rasteve të filmit klasik të situatave të emergjencave. Ekziston, natyrisht, një aspekt i zhvillimit etik të studentëve që është provinca e ligjit. Studentët e përjetojnë këtë në dy mënyra. “Në anën akademike të zhvillimit të tyre, çdo student merr një kurs thelbësor në ligj. Në këtë mënyrë, ligji përcakton 'moralin' e sjelljes së tyre, nën të cilën ata do të ndëshkohen me ligj. Për më tepër, e njëjta vepër penale mund të trajtohet si me sistemin e ndëshkimit ligjor ashtu edhe me sistemin e nderit.”<sup>165</sup> Përtej Kolegjit, ligji instrumentalizon ‘etikën’ duke rregulluar sjelljen në situatë emergjence në përputhje me Ligjin. Gjithashtu, duke përfituar sjelljen e duhur si shërbëtoresh e komunitetit.

“Ne jemi shumë të suksesshëm, në përgjithësi, në rregullimin, shpërblimin dhe ndëshkimin e sjelljeve të duhura të studentëve. A jemi në të vërtetë duke ngulitur zakonet e duhura? Në një farë mase, po sigurisht, por a mund të bënim më mirë? Ndoshta. Por kjo do të kërkojë të marrë më shumë rreziqe duke lejuar studentëve më shumë diskrecion në lidhje me zgjedhjet e tyre. Së dyti, përbërësi intelektual i zhvillimit etik - të menduarit e kujdesshëm dhe kritik për çështje etike komplekse - është thelbësore për zhvillimin e aftësisë reflektuese etike të pjekur dhe delikate”.<sup>166</sup>

Rinia nuk është faza më e mirë në zhvillim për studimin serioz të etikës për të gjitha arsyet që identifikohen. Të rinjtë kanë mungesë përvoja në jetë dhe në profesion që do t'i bëjë ata të mos e kuptojnë plotësisht rëndësinë e çështjeve. Ata nuk janë plotësisht të përgatitur të lejojnë arsyetimin të rregullojë jetën e tyre, pasi ata ende po luftojnë me pasionet dhe orekset të cilat nuk janë rregulluar akoma. Atëherë, për çfarë mund të shprejsojmë realisht në këtë fazë?<sup>167</sup> Së pari, ende mund të punohet në formimin e zakoneve. Së dyti, ne mund të motivojmë studentët dhe të inkurajojmë idealet e larta morale me anë të apeleve jo-rationale për emocione dhe modele të roleve për të imituar, të cilat, në momentet e saj më të mira, sigurojnë përpjekjet e zhvillimit të studentëve. Së fundmi, ne mund të fillojmë hedhjen e themelit në një klasë thelbësore të filozofisë, e cila, nëse është e efektshme, të paktën tregon se ekziston një metodë e një analize sistematike dhe racionale të çështjeve etike, dhe mbase i motivojmë ata të hulumtojnë ato pyetje më tej, pasi ata fitojnë përvojën e pjekurisë.

Të dobët dhe të shtypurit mund të kenë vetëm shkak që të fillojnë punën dhe të zhvillojnë operacionet e emergjencave, “por atyre u mungon forca mbizotëruese e të fortit”.<sup>168</sup>

Ndërtimi i paqes kërkon promovimin e drejtësisë sociale dhe ekonomike, si dhe krijimin ose reformimin e strukturave politike të qeverisjes dhe sundimit të ligjit. Këto aktivitete në fund të fundit po përpriqen të sjellin

<sup>163</sup> Edukimi i etikës në ushtri, E Redaktuar nga PAUL ROBINSON Universiteti i Otavës, Kanada dhe NIGEL DE LEE Universiteti i Hull, MB, Universiteti i Hull, MB, Britania e Madhe 2008, faqe 4

<sup>164</sup> Po Aty, faqe 58

<sup>165</sup> Po Art, faqe 62

<sup>166</sup> Po Aty, faqe 64

<sup>167</sup> Edukimi i etikës në ushtri, E Redaktuar nga PAUL ROBINSON Universiteti i Otavës, Kanada dhe NIGEL DE LEE Universiteti i Hull, MB, Instituti i Etikës së Aplikuar DON CARRICK, Universiteti i Hull, MB, Britania e Madhe 2008, faqe 65

<sup>168</sup> Etika e luftës - tradita të ndryshme dhe probleme të përbashkëta, E Redaktuar nga RICHARD SORABJI Wolfson College, Oxford, UK dhe DAVID RODIN Universiteti Oxford, MB, 2006, faqe 6

shërimin e një komuniteti të prekur nga lufta përmes pajtimit. Pajtimi, megjithatë, nuk është i qëndrueshëm pa rindërtim dhe zhvillim socio-ekonomik, asnjëra prej të cilave nuk mund të bëhet pa mobilizimin e burimeve. Ndërtimi i paqes është në të vërtetë një veprimtari politike por një veprim që synon të unifikojë sferat sociale dhe ekonomike.

Nuk është e thënë që nuk mund të zhvillohet ndërtimi i planeve të menaxhimit të emergjencave “pa përfshirë popullsitë lokale në hartimin, planifikimin dhe zbatimin i nismave”<sup>169</sup> për planëzimin dhe zhvillimin e operacioneve të emergjencave. Prandaj në këtë proces, që konsiderohet me shumë vlerë, pa edukimin etik “për një partneritet të ngushtë, respekt dhe dialog midis të gjithë aktorëve”.<sup>170</sup> As që mund të pretendohet për sukses në operacion. Në një kuptim shumë të vërtetë, atëherë, duhet të theksohet fakti se menaxhimi i emergjencave “në fund të fundit mund të ketë sukses vetëm nëse zhvillohet në bazë të një kornize etike”.<sup>171</sup>

Studimi i etikës është në lidhje me marrëdhëniet humane. “Ka të bëjë me çfarë ne duhet të bëjmë dhe duhet të jemi kur jemi pjesë e shoqërisë apo pjesë e një grupi apo e roleve që marrim gjatë jetës. Ka të bëjë me atë çka është e drejtë dhe e gabuar”.<sup>172</sup>

Shpesh njerëzit dëshirojnë të bëjnë një dallim midis fjalës etikë dhe moral. Shumica e njerëzve e lidhin etikën me vlerat sociale ndërsa moralin e lidhin me vlerat personale. Në studim këto fjalë përdoren në vend të njëra tjetrës. Në fakt shumica e filozofëve dhe historianëve këto fjalë i përdorin si sinonime.

Sipas fjalorit të Oksfordit përkufizimi i fjalës moral është: “Aftësia e dallimit midis të keqes dhe të mirës, asaj çka është e gabuar dhe e drejtë në lidhje me veprimet, vullnetin apo karakterin e qenieve njerëzore”. Ndërsa përkufizimi i fjalës etikë është: “Lidhja me virtytin ose veset, rregullat e sjelljes, zakoneve të jetës, mënyrat e sjelljes”.<sup>173</sup>

Ndonjëherë të qenit etik është të jesh efektiv dhe ndonjëherë të qenit efektiv është të jesh etik. Me fjalë të tjera, etika është efektivitet në raste të caktuara. “Ka raste kur thjeshtë të qenit i konsideruar si etik dhe i besueshëm e bën një lider efektiv dhe ka raste të tjera kur të qenit shumë efektiv e bën një lider të jetë etik”.<sup>174</sup> Etika lidhet me mënyrën se si individit e ndien si duhet të silllet. Ajo bën fjalë për vlerat dhe aplikimin e tyre në një kontekst të dhënë. “Faktori kryesor që ndikon për të kuptuar etikën është domethënia e mjedisit politik që siguron kuadrin për shërbime publike dhe që kushtëzon ushtrimin e tij”.<sup>175</sup>

Në demokraci është mjedisi politik ai që përcakton qëllimin dhe objektivat e shërbimeve edhe në procesin e menaxhimit të emergjencave; është mjedisi politik ai që përcakton vlerat që duhet të zbatohen kur kryhen këto shërbime; dhe është po mjedisi politik ai që, ndikon në mënyrën e punës së punonjësve që janë faktori kryesor i qëndrueshmërisë dhe modeli i forcës përballë të keqes, çeka nuk mund të realizohet pa një edukim të vijueshëm etik.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Chapman, R.A., (2002) Etika në Shërbimin Publik për Mijëvjeçarin e Ri, Ribotim shqip 2002, faqe 210
- Ned Lebow, R., (2007) - Detyrimi, Bashkëpunimi dhe Etika në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, (botim Anglisht), Washington, faqe 17
- Rhodes, B., (2009) Një hyrje në etikën ushtarake: një manual referimi, (botim Anglisht), Washington, faqe 2
- Edukimi i etikës në ushtri, E Redaktuar nga PAUL ROBINSON Universiteti i Otavës, Kanada dhe NIGEL DE LEE Universiteti i Hull, MB, Instituti i Etikës së Aplikuar DON CARRICK, Universiteti i Hull, MB, Britania e Madhe 2008, faqe 65
- Etika e luftës - tradita të ndryshme dhe probleme të përbashkëta, E Redaktuar nga RICHARD SORABJI Wolfson College, Oxford, UK dhe DAVID RODIN Universiteti Oxford, MB, 2006, faqe 6
- ETIKA e ndërtimitin e paqes, Tim Murithi, Britaninë e Madhe, EDINBURGH 2009, faqe 2 - 4
- Grup autorësh, etika dhe efektiviteti i liderit, (temë masteri), Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, faqe 3

<sup>169</sup> ETIKA e ndërtimitin e paqes, Tim Murithi, Britaninë e Madhe, EDINBURGH 2009, faqe 2 - 4

<sup>170</sup> Po Aty,

<sup>171</sup> Po Aty, faqe 5 - 8

<sup>172</sup> Grup autorësh, etika dhe efektiviteti i liderit, (temë masteri), Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, faqe 3

<sup>173</sup> Po Aty, faqe 4

<sup>174</sup> Grup autorësh, etika dhe efektiviteti i liderit, (temë masteri), Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, faqe 12

<sup>175</sup> Richard A. Chapman, Etika në Shërbimin Publik për Mijëvjeçarin e Ri, Ribotim shqip 2002, faqe 210